



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT
JAVA 18
27 prill – 03 maj 2026

Për këtë javë, kanë raportuar 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas çdo NJVKSH-je

Perqindja e plotesueshmerise				
Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	35 / 35	100%
		Kavajë	9 / 10	90%
	Durrës	Durrës	20 / 20	100%
		Krujë	6 / 6	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	13 / 13	100%
		Bulqizë	8 / 9	89%
ELBASAN	Elbasan	Elbasan	27 / 27	100%
		Librazhd	11 / 11	100%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	7 / 7	100%
	Korçë	Korçë	18 / 18	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	15 / 15	100%
		Kuçovë	4 / 4	100%
		Skrapar	7 / 7	100%
SHKODËR	Shkodër	Shkodër	19 / 19	100%
		M. Madhe	6 / 6	100%

	Kukës	Pukë	11 / 11	100%
		Kukës	14 / 14	100%
		Has	5 / 5	100%
		Tropojë	9 / 9	100%
	Lezhë	Lezhë	10 / 10	100%
		Kurbin	5 / 5	100%
		Mirditë	6 / 6	100%
	Vlorë	Vlorë	21 / 21	100%
		Sarandë	10 / 10	100%
		Delvinë	5 / 5	100%
VLORE	Fier	Fier	20 / 20	100%
		Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	6 / 9	67%
	Gjirokastër	Gjirokastër	21 / 21	100%
		Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	7 / 7	100%
		TOTAL	424 / 429	99%

Tabela 2. Numri Total i Rasteve të Sindromave të Survejancës “Alert” në Javën 18

	JAVA 18
Diarre pa gjak	1355
Diarre me gjak	0
Inf. Resp. të sipërme	7281
Inf. Resp. të poshtme	2816
Rash me temperaturë	26
Verdhëza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 javë)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut te neonatët	0
Numri i Njësive Raportuese	424
% e Njësive Raportuese	99% (424/429)



Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog, rastet e mëposhtme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për variçelë:



Tiranë – 12 raste

Fier– 6 raste

Vlore – 8 raste


Grafiku 1. Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas javëve**Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas grup-moshave**

Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 18 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 17.

Grafiku 3. Trendi në kohë i Diarreve pa gjak sipas javëve**Grafiku 4. Shpërndarja e Diarreve pa gjak sipas grup-moshave**


Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet rritje në javën 18 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 17.

Grafiku 5. Krahاسimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 18 krahasuar me javën paraardhëse, duke mbetur ne intensitet te ulët sezonal.

Grafiku 6. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” në javët 05 – 18 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.




Në javën 18 të vitit 2026 vërehet një ulje e numrit të Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme.

Grafiku 7. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000)




Grafiku 8. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas NJVKSH-ve në javën 17/2026 dhe 18/ 2026. Incidenca (raste/10.000).




Vërehet një rritje e infeksioneve respiratore në disa NJVKSH por aktiviteti i gripit ne total këtë javë paraqitet në rënie.

Grafiku 9. Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët 05-18 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.



Në javën 18 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”, këtë vit vërehet një numër më i madh i këtyre infeksioneve, krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 10. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH-ve në javën 17-18/2026 Incidenca (raste/10.000).



Vërehet një rritje e rasteve me diarre, veçanërisht në NJVKSH Kolonjë, Pogradec dhe Dibër, Mallakaster ku situata po monitorohet në mënyrë të vazhdueshme.

Ngjarje ndërkombëtare

Shpërthim i sëmundjes respiratore në anije turistike – Atlantiku Jugor, 2026 (Përmbledhje e shkurtuar)

Më **2 maj 2026**, Holanda raportoi në sistemin **EWRS** një shpërthim me etiologji fillimisht të panjohur në anijen turistike **MV Hondius**. Më **3 maj**, përmes sistemit Organizata Botërore e Shëndetësisë (**IHR**) u publikuan të dhëna të përditësuara për një klaster të **sëmundjes së rëndë akute respiratore (SARI)** me disa raste të rënda dhe vdekje. Një rast u konfirmua laboratorikisht pozitiv për **hantavirus** (PCR).

Situata epidemiologjike (deri më 3 maj)

- 4 raste të rënda (përfshirë 3 vdekje)
- 1 rast i konfirmuar me hantavirus
- Disa raste të lehta respiratore në bord
- Në anije: 147 persona (88 pasagjerë, 59 ekuipazh) nga 23 shtete
- Itinerari përfshin zona të Amerikës së Jugut dhe Atlantikut Jugor

Vlerësimi i riskut

- Rreziku për popullatën në BE/EEA dhe Shqipëri: **shumë i ulët**
- Transmetimi kryesor: kontakt me sekrecione të brejtësve
- Transmetimi njeri–njeri: i rrallë (i dokumentuar kryesisht për variantin Andes në Amerikën e Jugut)

Masat në bord dhe ndërkombëtare

- Izolim i rasteve simptomatike
- Distancim social dhe kufizim i lëvizjes
- Testime laboratorike (në Afrikën e Jugut dhe laboratorë referencë)
- Koordinim ndërmjet OBSH, vendeve të përfshira dhe Pikave Kombëtare të Kontaktit
- Hetime epidemiologjike dhe mjedisore në vazhdim

Këshilla kryesore nga OBSH

- Higjiena e duarve dhe higjiena respiratore
- Pastrim i shpeshtë i ambienteve (jo fshirje e thatë)
- Izolim dhe monitorim i rasteve
- Kujdes i hershëm mjekësor për simptomat respiratore
- Kontroll i ekspozimit ndaj brejtësve

Masa për Shqipërinë

- Monitorim i vazhdueshëm nga ISHP në bashkëpunim me OBSH dhe ECDC
- Rritje e vigjilencës në pikat hyrëse (porte dhe aeroport)
- Informim i strukturave shëndetësore dhe infeksionistëve
- Forcim i kapaciteteve laboratorike për diagnostikimin e HPS
- Bashkëpunim me laboratorë ndërkombëtarë referencë

Përfundim

Situata është nën monitorim ndërkombëtar dhe aktualisht nuk paraqet rrezik të shtuar për Shqipërinë. Informacioni mbetet i kufizuar dhe do të përditësohet sipas të dhënave të reja.

Gripi A(H5N1) –Monitorimi i rasteve në njerëz

- Më 29 prill 2026, OBSH raportoi një rast fatal njerëzor të infeksionit me virusin e gripit të shpendëve A(H5N1) tek një fëmijë nga Bangladeshi me fillimin e sëmundjes më 21 janar 2026.
- Pacienti ishte ekspozuar ndaj shpendëve të sëmurë dhe të ngordhur para fillimit të sëmundjes; mostrat mjedisore rezultuan pozitive për A(H5) nga shpendët në komunitet dhe nga mishi i pulës i ngrirë nga ngrirësi shtëpiak.
- Nuk janë zbuluar raste të reja midis kontakteve të ngushta të rastit.
- Që nga viti 2003, janë raportuar gjithsej 998 raste të konfirmuara njerëzore të A(H5N1) në të gjithë botën, përfshirë 478 vdekje (shkalla e vdekshmërisë së rasteve (CFR): 48%).
- Vlerësimi i rrezikut i ECDC për A(H5N1) mbetet i pandryshuar. Në përgjithësi, rreziku që lidhet me gripin zoonotik për popullatën e përgjithshme në BE/EEA konsiderohet i ulët.

Kolera –Monitorimi i shpërthimeve globale – Përditësim mujor

- Që nga 1 janari 2026 dhe deri më 28 prill 2026, janë raportuar 65 153 raste të kolerës, përfshirë 768 vdekje, në të gjithë botën.
- Që nga 30 marsi 2026 dhe deri më 28 prill 2026, janë raportuar 20 028 raste të reja të kolerës, përfshirë 272 vdekje të reja, në të gjithë botën.
- Pesë vendet që raportojnë më shumë raste janë Afganistani (7 446), Republika Demokratike e Kongos (6 146), Jemeni (1 564), Malavi (1 486) dhe Mozambiku (944).
- Pesë vendet që raportojnë më shumë vdekje të reja janë Republika Demokratike e Kongos (216), Angola (17), Nigeria (16), Kongo (12) dhe Zambia (4).
- Rastet e kolerës kanë vazhduar të raportohen në Afrikë, Azi, Lindjen e Mesme dhe Amerikë. Rreziku i infeksionit të kolerës tek udhëtarët që vizitojnë këto vende mbetet i ulët, edhe pse importimi sporadik i rasteve në BE/EEA është i mundur.

Sëmundja e virusit Chikungunya – Guiana Franceze, Francë – 2026

- Virusi chikungunya është në qarkullim të vazhdueshëm në Guianën Franceze, me 143 raste të raportuara që nga janari 2026.
- 80% e rasteve u konfirmuan në sektorin bregdetar dhe, më 23 prill, ky sektor u shpall në fazën epidemike të shpërthimit.
- Mundësia aktuale e infeksionit me virusin chikungunya për udhëtarët në Guianën Franceze vlerësohet si e ulët; mundësia e transmetimit të mëtejshëm në Evropën kontinentale pas hyrjes nga një udhëtar viremik konsiderohet shumë e ulët.
- Udhëtarëve duhet t'u këshillohet të marrin masa të përforcuara parandaluese të pickimit të mushkonjave. Vaksinimi mund të merret në konsideratë bazuar në rekomandimet kombëtare.